



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1544/13 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M
Nr. 910/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 867/2026, datë 25.06.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82199-04-16-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike..etj për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 5,985,918 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF, me NIPT (K71707007Q), me adresë: Lagja Katund i Ri, Rruga “Ali Pashë Gucia”, Godina Nr.5, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “KEJ Group” SHPK, me NIPT (M41707006H) dhe adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Pallatet Agimi, Shkalla 22, Ap. 370, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 867/2026, datë 25.06.2026, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” PF, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82199-04-16-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike..etj për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 5,985,918 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “KEJ Group” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” PF.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1840/11 prot., datë 07.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1544/10 prot., datë 09.07.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 867/2026, datë 25.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82199-04-16-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, hidraulike..etj për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 5,985,918 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 1840/11 prot., datë 07.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1544/10 prot., datë 09.07.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 867/2026, datë 25.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-82199-04-16-2026, me objekt: “*Blerje materiale elektrike, hidraulike..etj për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë*”, me fond limit 5,985,918 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P Nr. 867/2026, datë 25.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka zbatuar vendimin K.P.P Nr. 867/2026, datë 25.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-82199-04-16-2026, me objekt: “*Blerje materiale elektrike, hidraulike..etj për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë*”, me fond limit 5,985,918 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini